



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes inauguruese të Komitetit për barazi gjinore, mbajtur më 22.06.2022,  
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: anëtarët e Komitetit: Violeta Salihu, Besart Krasniqi, Dhurata Jahaj  
-Retkoceri, Gëzim Mehmeti dhe Leonora Shabani - Bajraktari.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Arton Brahimi**, me këtë

### REN D T Ë D I T Ë S:

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për barazi gjinore;
2. Të ndryshme.

**Arton Brahimi** bëri të ditur se për këtë takim është paraparë propozimi i njërit anëtar të komitetit për kryesues të Komitetit dhe e votojmë.

**Leonora Shabani - Bajraktari** shfaqti shpresën që ky komitet të jetë funksional. Ajo propozoi që kushdo që e merr besimin për kryesues të këtij komiteti, të jetë i përgjegjshëm dhe të krijojë politika në të mirë të të grave dhe vajzave në komunën e Prishtinës, përfaqësimin e tyre që dëshirojmë ta bëjnë.

**Arton Brahimi** tha se problemi në të kaluarën ka qenë se janë formuar komitetet, por shkak i mospagesës së anëtarëve të komitetit janë mbajtur vetëm nga një ose dy mbledhje dhe më nuk kanë vazhduar.

**Violeta Salihu** u shpreh se nuk është arsye mos me u mbajtur takimet kurrë për shkak të mospagesës, sepse tash para krejt organizatave ndërkombëtare Prishtina po qëndron më së keqi sa i përket barazisë gjinore, d.m.th. më së dobëti në tërë Kosovën.

**Leonora Shabani - Bajraktari** tha se në mandatin e kaluar i kemi pasur edhe kryesuesen e grupit të grave të asamblistëve dhe vetëm një takim e kemi mbajtur.

**Violeta Salihu** shprehu mendimin se këtu ka qenë punë vullnetare, por për me marrë fonde dhe granate prej organizatave për me përmirësuar punë, ka qenë mundësia shumë e madhe, edhe shumë më e madhe se që është tash, por prapë ka mundësi.

**Gëzim Mehmeti** e propozoi për kryesuese znj. Violeta Salihu.

Faqe 1 nga 4

Më vjen mirë që jam pjesë e Komitetit. Mua do të më keni gjithherë pjesë aktive në mbledhje, pa marrë parasysh se a paguhen apo nuk paguhen, jam për me kontribuar sa herë keni nevojë.

**Arton Brahimi** tha se mund ta thërrasim edhe Premtime Preniqin, e cila është zyrtare për barazi gjinore në Komunën e Prishtinës. Nuk është pjesë e komitetit, por ka me marrë pjesë në mbledhje dhe ajo mund të ju njoftoj paraprakisht me planet çka mundet me u punuar më konkretisht.

**Leonora Shabani - Bajraktari** e propozoj Violeta Salihun për kryesuese.

**Dhurata Jahaj - Retkoceri** tha se unë si kryesuese e Grupit të grave në Kuvend, kam menduar për Violetën, megjithatë po më vjen mirë që të gjithë jeni për Violetën.

**Violeta Salihu** tha shumë mirë që Dhurata është me neve në grup, se zëvendësambasadori i OSBE-së më tha se është mirë me bashkëpunuar edhe me grupin e grave.

Po ashtu, ceku se mangësia te komitetet është se nuk kishin rregullore.

**Gëzim Mehmeti** tha se ka rregullore, përfshihen në Udhëzim administrativ edhe komitetet tjera.

**Violeta Salihu** theksoi se duhet me qenë një rregullore specifike, që e tregon punën tonë, rëndësinë tonë dhe rolin se çka mundemi ne me bërë, deri ku mundmi me shkuar.

**Gëzim Mehmeti** u shpreh se qenka Rregullorja për themelimin, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve në Komunën e Prishtinës.

**Arton Brahimi** theksoi se këto komitete janë konsultative, d.m.th. këto nuk janë të obligueshme për t'u formuar nga Komuna, vetëm nëse ndonjë drejtori e sheh të arsyeshme, p.sh. me formuar një komitet brenda drejtorisë që me u marrë me ato punë brenda asaj drejtorie.

**Leonora Shabani - Bajraktari** tha se ne mundemi me bashkëpunuar edhe me drejtoreshën e Mirëqenies Sociale, Drejtorinë e Shëndetësisë, dhe mund të kontribuojmë shumë në këtë fushë.

**Violeta Salihu** tha se ne kishim të drejtë bashkërisht me bërë një rregullore, e që mundemi me dërguar në MAPL dhe me vlerësuar ata ligjshmërinë e rregullores. Kjo do të jetë më e mira nëse mundemi me bërë, nëse kthehet ligjshmëria, mandej kjo mbetet për të gjitha komitetet në periudhën e ardhshme.

**Arton Brahimi** dha sqarime, duke thënë se këto komitete konsultative kanë me qenë me pagesë, nëse nuk gabo, këto kanë me qenë 6 mbledhje brenda vitit që do të paguhen. Mund të thirrni ndonjë drejtor nëse e shihni të nevojshme, me qëllim bashkëpunimi për mbledhje.

**Leonora Shabani - Bajraktari** tha se edhe në mandatin 2014-2017, por edhe më herët, ndoshta ka qenë funksional Grupi i grave asambliste.

**Violeta Salihu** tha se edhe performanca e Zyrës për barazi gjinore ishte e vlerësuar shumë ulët. Njëherësh bëri të ditur se Donjeta, nënkryetarja, ishte duke u marrë me barazi gjinore, ishte duke u marrë me Planin e veprimit, bashkë me ekspertë.

**Dhurata Jahaj - Retkoceri** u shpreh se kur të kthehem nga pushimi, e caktojmë një takim me Donjetën Sahatçiu, nënkryetaren, dhe diskutojmë për këto çështje.

**Violeta Salihu** tha se edhe ne duhet me pasur Plan të veprimit, nëse dëshirojmë me u takuar me organizata ndërkombëtare, duhet pasur një plan para vetes, e ne aty bashkërisht mundemi me dhënë kontribut.

**Gëzim Mehmeti** shprehu mendimin se është mirë që ne të bëjmë një plan paraprak dhe të jepem propozime të ndryshme se ku po përcaktohem për vitin e parë - të dytë - të tretë - të katërt të mandatit.

**Violeta Salihu** sugjeroi me filluar me bërë një projektplan dhe me i dhënë rekomandimet, me qenë si bazë.

Është mirë për këtë fillim të takohemi më shpesh.

**Leonora Shabani - Bajraktari** theksoi se ne mundem edhe përmes Google-shqip me krijuar dhe aty japim rekomandimet, kush çka ka me bërë e planifikojmë secili.

Unë mendova me qenë si grup punues dhe me dhënë propozime, që të mos i bie barra vetëm njërit nga anëtarët.

**Arton Brahimi** tha se mundet të ju ndihmoj edhe Premtimja, ndoshta ata edhe e kanë Planin, në bazë të të cilit edhe punojnë. Nëse ju keni ndonjë rekomandim tjetër mundeni me u inkuadruar në atë plan me ndonjë ndryshim etj.

**Leonora Shabani - Bajraktari** tha se duhet ta kemi një plan që të jetë funksional, kuptohet me shikuar edhe me grupin e grave asambliste qysh mundemi me bërë një gjë më të madhe, p.sh. me iniciativa vetanake patëm bërë qasje për fëmijët me nevoja të veçanta në shkollën "Eqrem Çabej". Unë më shumë jam eksperte për PAK, por janë grupe që janë shumë më të marginalizuara, p.sh. nënat që kanë fëmijë me nevoja të veçanta janë dy herë më të diskriminuara, gratë që janë me nevoja të veçanta, me aftësi të kufizuara janë dy-tri herë më shumë, kështu që ne mundemi me bërë edhe takime me të gjitha organizatat, se edhe ato janë të gatshme me u takuar me njerëz, zyrtarë të Komunës, që mund të gjejnë një përkrahje.

**Violeta Salihu** tha se ky rregullimi i kësaj lëvizjes për PAK është mbetur si gjysmak, se është bërë vetëm hyrja në objekt, lëvizshmëri në objekt më tutje nuk ka.

**Leonora Shabani - Bajraktari** tha se është viti i aftësive të kufizume dhe ne po e marrim më parësore për këtë vit me bërë diçka për aftësinë e kufizuar, t'i qesim në pah nënat që kanë fëmijë me nevoja të veçanta dhe gratë apo vajzat që janë me aftësi të kufizuara.

**Dhurata Jahaj - Retkoceri** tha se kjo çështje është problematike, edhe nënat me karroca me bebe.

**Gëzim Mehmeti** theksoi se Prishtina ka mjaft trotuare, problemi kryesor është te parkingjet që bëhen nga veturat në trotuar. Tash Komuna e Prishtinës nuk ka kapacitete, sepse janë 23 policë të komunikacionit me tri ndërresa, është e pamundur me kontrolluar. Nëse nuk kanë vetëdije, nuk ka qeverisje as ekzekutiv që mundet me rregulluar, se këtu duhet të gjithë mekanizmat shtetëror dhe komunal me hy bashkë për me mundur me zgjidhur problemin e parkingut.

Nëse doni me sensibilizuar këtë çështje, lejet që janë lëshuar 2014-2015 e kanë obligim edhe çështjen e trotuareve, kopshteve etj. Tash sa po zbatohen është çështje tjetër, se investitorët kur e marrin lejen, një pjesë 60% e di se në shumicën e rasteve i jepet për aktivitete, kopshte me pasur afër etje., kjo nuk po respektohet nga investitorët, e këtu është problemi. Këtë mundeni me sensibilizuar me nënat që me shty, se investitorët nuk po i respektojnë lejet e tyre.

**Arton Brahimi** shprehu mendimin se e mira e këtyre komiteteve është se ju jeni katër veta që jeni anëtarë të Kuvendit dhe çka do që mundeni me nxjerrë, ndonjë rekomandim, mundeni me shkuar direkt në Kuvend me paraqitur, me u bërë diçka më e madhe, kjo është mënyra më e drejtë me arritur diçka më konkrete.



**Leonora Shabani - Bajraktari** tha se çdo gjë që ka të bëjë me të drejtat e njeriut votohet në Kuvend.

**Violeta Salihu** sugjeroi që me shkuar me parë eksperiencën e një komunë tjetër, qoftë në Kosovë, qoftë jashtë Kosovës, ndoshta mund të na ofrojnë planin e punës, me parë p.sh. çka ka bërë Klina, çka ka bërë Malisheva, duhet bërë disa analiza.

**Leonora Shabani - Bajraktari** tha se ne nuk duhet bazuar shumë te komunat tjera, se nevojat nga komuna në komunë ndryshojnë, mentaliteti tjetër etj. Ne duhet të dalim me diçka si kryeqytet.

**Violeta Salihu** tha ne duhet ta bëjmë Planin e veprimit. Nuk besoj se është problem çështja e shpenzimeve, OSBE-ja na ofron këtë.

**Arton Brahim** tha se komitetet e përhershme, sipas Udhëzimit administrativ, parashihet që me raportuar Planin vjetor të punës në Kuvend, por për komitetet konsultative nuk është e obligueshme, përveç kryesueses-kryesuesit të komitetit, në rast mungese e zëvendëson anëtari më i vjetër i Komitetit.

Anëtarët e Komitetit njëzëri e votuan për kryesuese të Komitetit znj. Violeta Salihu.

*Mbledhja përfundoi në orën 10:40.*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**



**Kryesuesja e Komitetit  
Violeta Salihu**

Faqe4nga4